



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

Durrës më, 08.05.2026

NJOFTIM PËR SHPALLJEN E REZULTATEVE TË VLERËSIMIT

**NË KUADËR TË THIRRJES PUBLIKE:
“GRANTE PËR TË RINJTË NË MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT TË INICIATIVAVE
EKONOMIKE LOKALE”**

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 115 datë 24/12/2024 “Për miratimin buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027” dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 66 datë 11.11.2025 “Për Miratimin e Udhëzuesit për Mënyrën e Aplikimit “Për Implementimin e Skemës: Grante për të Rinjtë në Mbështetje të Zhvillimit të Iniciativave Ekonomike Lokale”, Bashkia Durrës më datë 21 nëntor 2025, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 9 datë 10.02.2026 Bashkia Durrës më datë 27 Shkurt 2026 ka shpallur thirrjen publike: “Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale”, të financuar nga buxheti i Bashkisë Durrës.

Për sa më sipër ju informojmë se:

Referuar Udhëzuesit të Aplikimit, pika 9.4 ‘Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve’, Komisioni i Vlerësimit, ka kryer vlerësimin dhe më pas rivlerësimin e 6 (gjashtë) dosjeve të aplikimeve të dorëzuara pranë Bashkisë Durrës, në bazë të kushteve administrative dhe kushteve që kanë të bëjnë me aplikuesin si edhe me realizueshmërinë e idesë, planit të biznesit dhe financimit.

Pas përfundimit të fazës së dytë të procesit të vlerësimit dhe verifikimit të dokumentacionit, Komisioni i Vlerësimit ka vendosur, në unanimitet të plotë si më poshtë:

Nr.	Emri i Aplikantit	Pikët	Vlerësimi
1	Irakli Pina	80.8	Fitues
2	Seldan Tabaku	75.8	Fitues
3	Ramona Salianj	72.2	Fitues
4	Aldo Mustafa	N. A	Skualifikohet
5	Armela Curri	N. A	Skualifikohet
6	Irena Leshi	N. A	Skualifikohet

Pas botimit zyrtar të rezultateve, aplikuesit kanë të drejtë të ankimojnë rezultatin brenda *pesë ditësh pune* nga marrja e njoftimit.